BASHKIA KRUJË
KESHILLI BASHKIAK
Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skënderbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al.

NJOFTIM

KRUJË më, 21.1.2026.

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Krujë.
Drejtuar:Z/Znj i Nderuar Këshilltar.

Ju njoftojmë se ditën e Martë, datë 27.1.2026, ora 11:00 do zhvillohet mbledhja e Këshillit bashkiak, mbledhje e cila do zhvillohet në sallën e mbledhjeve bashkia Krujë, mbledhje e thirrur nga Kryetari i Bashkisë, në bazë të ligjit, 139/2015, neni 53 pika 4, si dhe rregullores së Këshillit Bashkiak nr,11 datë 30.01.2020, me këtë rend dite:

1. Të tjera.
2. Për miratimin e Proçesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak".
3. Për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit të sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar te bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind për vitin 2026"
4. Për propozimin për përfitimin e shërbimit pa pagesë të kopshteve dhe çerdheve për fëmijët e familjeve me probleme sociale dhe ekonomike për vitin 2026.
5. Për miratinim e perdorimit të fondeve të rindërtimit në zbatim të VKM nr.816 datë 30.12.2025.
6. Për miratimin e perdorimit të fondeve të rindërtimit në zbatim të VKM nr.820 datë 30.12.2025.
7. Për miratimin e programit të punës së këshillit të bashkisë krujë për periudhën janar 2026 – dhjetor 2026
8. Për miratimin e listës së familjeve të pastreha në bashkin krujë, dhe pikët përkatësë".

Sekretari i Këshillit

Gjon Iata

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
KESHILLI BASHKIAK
KRYESIA
Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skënderbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al.

**Krujë më 23.1. 2026**

**VENDIM**

**Nr 1, datë 23.1.2026.**

**MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", neni 17,56, 57 dhe Rregulloren për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Krujë, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Krujë në mbledhjen e datës 27.11.2023.

**VENDOSI**

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Krujë, e cila do të mbahet në datën 27.1.2026.

2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit, në mungesë Kryetari i këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës të çdo këshilltar, të Kryetari i Bashkisë Krujë, Deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**
**VITORE TOTRRI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA KRUJE

Prot 6021/1
dt 060226

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 95/ prot. Durrës, më 04.02.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**KRUJË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**KRUJË**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.1 dt.27.01.2026, "Për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit të sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2026".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**
**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT DURRËS

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KRUJË**
**KESHILLI BASHKIAK**

**Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skënderbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al.**

**VENDIM**

**NR 1 DATË 27/1/2026.**

## MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT TE SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TE BLLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr.9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Repuplikën e Shqiperisë" i ndryshuar sipas Ligjit nr. 87/2025 datë 24.12.2025, "Për buxhetin qëndror 2026" si dhe VKB Nr.68 datë 23.12.2025, si dhe Ligji nr.57/2019, " Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë", me VKM nr.597 datë 04.09.2019, si dhe Vendim nr. 868 dt. 29.12.2021, " Për përcaktimin e kritereve të proçedurave si dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" si dhe Udhëzimeve nr. 3,4,5 date 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% me fondet e pushtetit qëndror, Këshilli Bashkiak vendosi:

1. Miratimin e kritereve të ndihmës ekonomike për familjet të cilat nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzmit të parashtruar si më poshtë :

- Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 muajve të fundit nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
- Njësitë Administrative dërgojnë çdo muaj pranë Drejtorisë së Shërbimit Social listën e përfituesve, shoqëruar me projekt-vendim dhe relacion.
- Familje të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me fondin 6% duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyrat e ndihmës ekonomike.

- Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevojë dhe pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Rastet kur K/familjari ose dhe antarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjistacionit në fuqi nuk pëfitojnë pagesën e P.A.K.
- Familjet me K/familjare gra dhe burra të ve , të divorcuar me të paktën një fëmijë nën 14 vjeç që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
- Familje që ka gra ose individ te moshuar të vetmuar.
- Familje që janë në moshe pensioni dhe nuk e përfitojnë dot pensionin e pleqërise.

Masa e ndihmës ekonomike të çdo familje të llogaritet sipas Udhëzimit Nr. 4 datë 17.02.2017 për llogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike.
Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Krujë do të përcaktojë çdo muaj numrin e familjeve për çdo Njësi Administrative në bazë të fondit të disponueshëm.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtijë vendimi drejtoria e shërbimit Social bashkia Krujë.
3 Ky vendim hynë në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETARI I KESHILLIT**
**VITORE TOTRRI**

**U shpall sot me datë 27 / 1 /2026.**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 95/2 prot. Durrës, më 04.02.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**KRUJË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**KRUJË**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.2 dt.27.01.2026, "Për miratimin e përfitimit të shërbimit pa pagesë të kopshteve dhe çerdheve për fëmijët e familjeve me probleme sociale dhe ekonimike për vitin 2026".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**
**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skëndërbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al.

**VENDIM**

**NR 2 - DATË 27/ 1 /2026.**

## Miratimi e përfitimin të shërbimit pa pagesë të kopshteve dhe çerdheve për fëmijët e familjeve me probleme sociale dhe ekonomike për vitin 2026.

Në mbështetje të ligjit Nr.139. datë 17.12.2015. Për vetëqeverisjen vendore Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Repupliкën e Shqiperisë" i ndryshuar sipas Ligjit 87/2025 datë 24.12.2025 " Për buxhetin qëndror 2026" si dhe VKB Nr 68 datë 23.12.2025 si dhe Ligji Nr.57/2019 si dhe Vendim nr 868 dt 29.12.,2021 ,"Për asistencen sociale në Republiken e Shqiperise" si dhe , Udhëzimeve nr.3,4,5 date 17.02.2017 meVKM nr.597 datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kritereve të proçedurave si dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" Ligjin nr 8626 date 22.06.2000 "Statusi i invalidit para dhe tetraplegjik" i ndryshuar, ligji nr 7889 date 14.12.1994 "Per statusin e invalidit' i ndryshuar, VKM nr 618 date 07.09.2006, i ndryshuar me Vendim Nr.813. date 29.12. 2017 si dhe i ndryshuar, me VKM Nr.182 date 26,02,2020 "Per percaktimin e kritereve te dokumentacionit dhe mases se perfitimit te pageses per personat me aftësi te kufizuar si dhe te ndihmësit personal",VKM nr 277 date 18.06.1997, "Për përfitimet nga statusi i te verberit" i ndryshuar me VKM nr.31 date 20.01.2001 "Per perfitimet nga statusi i invalidit para dhe tetraplegjik" i ndryshuar., këshilli bashkiak vendosi:

1. Miratimin e shërbim pa pagesë në Kopshtet dhe Çerdhet që janë në varësi të Bashkisë Krujë , kategoritë si më poshtë :

- Familjet në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe në sistemin e pikëzimin 6 %.
- Fëmijë me statusin e jetimit.
- Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor i fëmijës është i ve ( sipas certifikatës së gjëndjes familjare).

- Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike sipas komisionit Mjekesor te Caktimit te Aftesise per Pune.
- Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda , sipas raportit të komisionit Bio-psikosocial
- Fëmijë të Komunitetit rom dhe egjiptian
- Fëmijët e familjeve me nevoja të vecanta apo ekstremisht të varfëra të cilat evidentohen gjatë punës së Drejtorisë së Shërbimit Social.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtijë vendimi drejtoria e shërbimit Social bashkia Krujë.
3 Ky vendim hynë në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETARI I KESHILLIT**
**VITORE TOTRRI**

**U shpall sot me datë 27 / 1 /2026.**

Prot. 602/3
dt 06.02.26

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 95/3 prot. Durrës, më 04.02.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**KRUJË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**KRUJË**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.3 dt.27.01.2026, "Për përdorimin e fondeve të rindërtimit".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**
**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT DURRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
KËSHILLI BASHKIAK
Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skëndërbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al

# VENDIM

NR 3 , DATË 27/ 1 /2026

PËR

"PERDORIMIN E FONDEVE TE RINDERTIMIT"

Bashkia Krujë , mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",Ligjit 68/2017 "Per financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 10296 date 08.07.2020 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin ",VKB nr. 68 datë 23.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026,

VKM- së nr.816 Datë 30.12.2025 ."Per perdorimin e fondit te rindertimit , për Financimin e Rindertimit te Banesave Individuale ne Bashkine Kruje", Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr 9 date 20.03.2018 "Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit Keshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim projekt- vendimin e paraqitur nga kryetari i Bashkise dhe stafi i tij në përfundim :

## KËSHILLI I BASHKISË

## VENDOSI :

1. Miratimin e perdorimit te fondeve te Rindertimit ne zbatim te VKM nr 816 date 30.12.2025 si më poshtë :

| Inst | Ministria e Linjes | Inst | Emri i institucionit | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi i deges se Thesarit | Kod Produkti | Emri I produktit | Vlera e Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 123 | 00 | 2123001 | Bashkia Kruje | 01 | 04960 | 6060000 | 716 | 94902AC | Rindertimi I banesave individuale Kruje(DS4/DS5) | 177,818,041 |

2. Ngarkohet Drejtoria e Financës për Zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike ( sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore")

**KRYETARI I KESHILLIT**
**VITORE TOTRRI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE

U shpall sot me date 27/ 1 /2026

Adresa Qendër Krujë ,Tel./Fax 00355 511 2 21 70 E-Mail info@kruja.gov.al

Rrot 602/4
Dt 060226

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 95/4 prot.

Durrës, më 04.02.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**KRUJË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**KRUJË**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.4 dt.27.01.2026, "Për përdorimin e fondeve të rindërtimit".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**
**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
KËSHILLI BASHKIAK
Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skënderbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al

# VENDIM

## NR 4, DATË 27/1/2026

## PËR

## "PERDORIMIN E FONDEVE TE RINDERTIMIT"

Bashkia Krujë , mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",Ligjit 68/2017 "Per financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 10296 date 08.07.2020 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin ",VKB nr. 68 datë 23.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026,

VKM- së nr.820 Datë 30.12.2025 ."Per perdorimin e fondit te rindertimit , për Financimin e Rindertimit të Shkolles së Mesme të Bashkuar Ramazan Karaj, Bashkia Kruje", Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr 9 date 20.03.2018 "Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit Keshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim projekt- vendimin e paraqitur nga kryetari i Bashkise dhe stafi i tij në përfundim :

## KËSHILLI I BASHKISË

## VENDOSI :

1. Miratimin e perdorimit te fondeve te Rindertimit ne zbatim te VKM nr 820 date 30.12.2025 si më poshtë :

| Inst | Ministria e Linjes | Inst | Emri i institucionit | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi i deges se Thesarit | Kod Produkti | Emri I produktit | Vlera e Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 123 | 00 | 2123001 | Bashkia Kruje | 01 | 04960 | 2310000 | 716 | 94902AC | Rindertimi i Shkolles së Mesme të Bashkuar Ramazan Karaj, Bashkia Kruje | 63,080,290 |

2. Ngarkohet Drejtoria e Financës për Zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike ( sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore")

**KRYETARI I KESHILLIT**
**VITORE TOTRRI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE -

U shpall sot me date 27 / 1 /2026

Adresa Qendër Krujë ,Tel./Fax 00355 511 2 21 70 E-Mail info@kruja.gov.al

Prot 602/5
06.02.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 95/5 prot. Durrës, më 04.02.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**KRUJË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**KRUJË**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.5 dt.27.01.2026, "Për miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Krujë për periudhën Janar 2026- Dhjetor 2026.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**
**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skëndërbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al.

# PROJEKT-VENDIM

Nr. 5, datë 27. 1 .2026

## PËR
## MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË KRUJË PËR PERIUDHËN JANAR 2026 – DHJETOR 2026

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë "Qeverisja Vendore" e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar , neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma "b", të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, , Neni 119 "Programi i Punës së Këshillit Bashkiak" dhe sipas relacionit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, Kryetari i Këshillit i propozon Këshillit Bashkiak,

## TË VENDOSI:

1. Miratimin e programit të punës dhe buxhetit të Këshillit të Bashkisë Krujë për periudhën Janar 2026 – dhjetor 2026, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Këshilli Bashkiak Krujë dhe Kryetari Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Vitore Totrri**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... KRUJË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KRUJË**
**KESHILLI BASHKIAK**
**Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skëndërbej, tele 051122170 e-mail:infokruja@gov.al.**

**VENDIM**
Nr. 5, datë 27. 1.2026

**PËR**
**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË KRUJË PËR PERIUDHËN JANAR 2026 – DHJETOR 2026**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë "Qeverisja Vendore" e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar , neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma "b", të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, , Neni 119 "Programi i Punës së Këshillit Bashkiak" dhe sipas relacionit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, Këshillit Bashkiak,

**V E N D O S I :**

4. Miratimin e programit të punës dhe buxhetit të Këshillit Bashkisë Krujë për periudhën Janar 2026 – dhjetor 2026, bashkëngjitur këtij vendimi.
5. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Këshilli Bashkiak Krujë dhe Kryetari Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Vitore Totrri**

**U shpall sot me date 27/1/2026**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KRUJË -

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Prot 602/6
060226

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 95/6 prot.

Durrës, më 04.02.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**KRUJË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**KRUJË**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.6 dt.27.01.2026," Për miratimin e familjeve të pastreha në Bashkinë Krujë dhe pikët përkatëse".

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (neni 8/a) i ndryshuar "Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **<u>nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.</u>**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**
**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
KËSHILLI BASHKIAK

# VENDIM
## NR. 6 datë 27. 1 .2026

**"MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE TË PASTREHA NË BASHKIN KRUJË, DHE PIKËT PËRKATËSË".**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social",VKM nr.384 datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm që duhet të paraqes familja për të përfituar strehim në një nga programet sociale", afateve dhe proçedurave të miratimit nga organet e Qeverisjes Vendore", relacionit bashkelidhur dhe me propozim te Kryetarit te Bashkise:

**KËSHILLI BASHKIAK**
**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së familjeve të pastreha dhe pikët përkatëse në Bashkin Krujë sipas tabelës në vijim.

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | Përbërja Familjare | Struktura e apartamentit që përfiton | Statusi social i familjes | Pikëzimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Astrit Qamil Mesi | 3 | 2+1 | | 20 |
| 2 | Agron Hasan Boja | 4 | 2+1 | | 20 |
| 3 | Aleksandër Kujtim Paja | 1 | Gasioniere | | 20 |
| 4 | Denis Shefqet Kasalla | 5 | 3+1 | | 20 |
| 5 | Fatos Hamdi Qosja | 3 | 2+1 | | 20 |
| 6 | Fatmir Syl Imeri | 4 | 2+1 | | 20 |
| 7 | Avni Ali Paluci | 4 | 2+1 | | 15 |
| 8 | Edmirda Petrit Masha | 3 | 2+1 | | 20 |
| 9 | Indrit Xhemali Kullaj | 1 | Gasioniere | | 20 |
| | | | | | |
| 10 | Bib Ded Pula | 1 | Gasioniere | | 20 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Jetmir Ded Pula | 4 | 2+1 | | 20 |
| 12 | Gentian Ded Pula | 4 | 2+1 | | 20 |
| 13 | Eduart Ded Pula | 4 | 2+1 | | 20 |
| 14 | Miranda Ramazan Baku | 5 | 3+1 | | 20 |
| 15 | Jeta Petrit Zeneli | 2 | 1+1 | | 20 |
| 16 | Petrit Sinan Loci | 3 | 2+1 | | 20 |
| 17 | Marc Preng Pikuli | 1 | Gasioniere | | 20 |
| 18 | Mark Vlash Cani | 2 | 1+1 | | 20 |
| 19 | Sami Xhemali Hushi | 3 | 2+1 | | 20 |
| 20 | Kastriot Kadri Toçi | 7 | 3+1 | | 20 |

2. Të miratojë listën e sipër përmendur që fillon me nr. rendor 1 (një) dhe mbaron me nr,rendor 20( Njëzet).

3.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Sektori i Strehimit, ne Drejtorine e Shërbimeve.

4.Ky vendi, hynë në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike,( sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", të ndryshuar)

U shpall sot me datë 27. 1 .2026

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**VITORE TOTRRÍ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE -